

URDHËR
Nr. 36, datë 17.3.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të rregullores së brendshme të miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 30, datë 24.2.2022, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Media dhe Informim”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave, znj. Denada Qirici, zëvendës drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim, për të gjitha procedurat që lejon ligji, për aq sa është e mundur dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë kompetencën për kalimin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve operative, në Agjencinë për Media dhe Informim.

2. Arsyeja e delegimit të kompetencave lidhet me mungesën e drejtorit të përgjithshëm.

3. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen për periudhën nga data 18.3.2025 deri në datën 7.4.2025.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Denada Qirici, zëvendës drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Alteo Hysi